



Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Të kenë përfunduar një vit akademik, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Kohëzgjatja e bursave:

- Për studentët: 1 semestër, 19.02-30.06.2022

Fushat e studimit:

Arkitekturë dhe Urbanistikë

Numri total i studentëve në Bachelor, Master: 3 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*



**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Applied Sciences In Nysa, Poloni, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

Për të parë listën e lëndëve dhe për të marrë informacion të përgjithshëm rreth studimeve në Applied Sciences in Nysa, Poloni, ju lutemi klikoni te linku:

[erasmus_architecture.pdf \(pwsz.nysa.pl\)](#)

Afati për aplikim: Deri më 10 Nëntor 2021

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al